

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. N. nga Prizreni, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1806-6/16 të datës 03.11.2016, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të KP-së, në shqyrtimin fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarit L. N., me datë 03.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

L. N., nga i ati F. dhe e ëma S. i lindur më 1. N. në Prizren ku edhe tani banon, në rr. " " nr. ose në rr. " " nr. , i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të ID " .

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 28.06.2016, rreth orës 09:20 minuta, në Prizren, saktësisht në rrugën me kryqëzim " " , rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 49 dhe 64 të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve-kamionet rimorkio të markës "Iveco 3.3", me targa të regjistrimit " " , ngjyrë të kuqe, duke mos mbajtur anën e djathtë të lëvizjes, me pjesën e përparme të rimorkios e godet çiklistin Z. B. i cili në atë moment inkuadrohet në rrugë, me ç'rast përpos dëmeve materiale, lëndime të rënda trupore pëson çiklisti: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e gjurit të djathtë dhe kërcirit të majtë, dhe atë: ndrydhje të buta në regjionin e kokës, regjionin e hundës, regjionin e gjoksit dhe regjionin klavikular, plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e vetullës së djathtë, thyerje e kockës së kafkës në regjionin e djathtë ballor, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjore dr. N. U. , të datës 23.09.2016.


Kështu që ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ja vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 2 (dy) vitesh nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari: Z. B. nga Prizreni, në rr. " " , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civilo-juridik.



I akuzuari, obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato, sipas llogarisë së bërë në arkën e kësaj gjykate, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, dhe për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 81.76 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Arsyetim


Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr.1806-6/16 të datës 03.11.2016, kundër të akuzuarit L. N. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të KP-së.

Gjykata më datën 03.11.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e prokurorit, dhe të akuzuarit. Prokurori në shqyrtimin fillestar e ka ricilësuar akuzën nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP -së në nenin 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KP -së. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale që më vihet në barrë dhe pranueshmërinë e provave, duke shtuar se i vie keq për veprën që ka kryer dhe në të ardhmen nuk do përsërisë vepra të tilla.

Gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 28.06.2016, rreth orës 09:20 minuta, në Prizren, saktësisht në rrugën me kryqëzim " ", rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 49 dhe 64 të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve-kamionet rimorkio të markës "Iveco 3.3", me taqta të regjistrimit " ", ngjyrë të kuqe, duke mos mbajtur anën e djathtë të lëvizjes, me pjesën e përparme të rimorkios e godet çiklistin Z. P. , i cili në atë moment inkuadrohet në rrugë, me ç'rast përpos dëmeve materiale, lëndime të rënda trupore pëson çiklisti: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e gjurit të djathtë dhe kërcirit të majtë, dhe atë: ndrydhje të buta në regjionin e kokës, regjionin e hundës, regjionin e gjoksit dhe regjionin klavikular, plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e vetullës së djathtë, thyerje e kockës së kafkës në regjionin e djathtë ballor, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjore dr. N. U. , të datës 23.09.2016.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përmbante asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj. Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se në gjykim ka patur qëndrim korrekt, pranimi i fajësisë, nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar, mënyrën dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale, është cenuar vlera e mbrojtur integriteti trupor i të dëmtuarit pasi që ka pësuar lëndime të rënda trupore.



Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par. 2 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 par. 4 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 2424/16, me datë 03.11.2017

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.